

SPECIFIKIME TEKNIKE PER KOPSHTIN NE LAGJEN NR 1 KAVAJE.

1.PUNIME BETONI E B/A PER RRETHIMIN E JASHEM

Plinta,kollona e trare prej betoni M 250 te dozuar m³ dhe te vendosur ne objekt dhe te vibruar mire,me qellim qe te dale nje pune me cilesi.

-Beton marka 100 me *zhavorr natyror*: Çimento 240kg m 400 , zhavorr m³ 1,05 , uje m³ 0,19 .

- Beton marka 150 me *inerte* , konsistence 3-5 cm,granil deri 20 mm, rërë e lare me modul 2,6: Çimento 400 kg 260 , rërë e lare m³ 0,44 , granil m³ 0,70, uje m³ 0,18.

- Beton marka 200 me *inerte* , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm,rërë e lare me modul 2,6: Çimento 400 kg 300 , rërë e lare m³ 0,43 , granil m³ 0,69 , uje m³ 0,18 .

- Beton marka 250 me *inerte* , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm,rërë e lare me modul 2,6: Çimento 400 kg 370 , rërë e lare m³ 0.43, granil m³ 0,69 , uje m³ 0,185
Ne punimet b/a lloji I armatures se perdorur eshte e percaktuar ne projekt.

2.PUNIME SHITESASH

Shtrimi I dyshemese me pllaka grez porcelain behet ne kete menyre. Duhet qe vendi te pastrohet dhe te lahet me uje me presion.Pllakat e reja te zgjidhen nga investitori dhe nga supervizori qe te mos jene te rreshqitshme dhe te jene cilesore .Pllakat e reja te jene me te njejten ngjyre dhe me dimensione te njejta si pllakat e vjetra dhe te vendosen ne llacin e shtruar.LLaci per riparim duhet te pergatitet me permbajtje:per 1,02 m² pllaka nevojiten 0.02 m³ llac te tipit m 15 me 4 kg cimento(m400).Pastaj duhet qe fugat te mbushen me masen perkatese(bojak) te pastrohen dhe te kryhen te gjitha punet e tjera. Dhomat e femijeve jene planifikuar me parket ku cilesia e tij te percaktohet nga supervizori dhe investitori gjithashtu te vendosen sipas kushteve teknike per vendosjen e parketeve.

3.PUNIME DYER DRITARE

Dyert dhe dritaret jane nje pjese e rendesishme arkitetionike dhe funksionale e ndertesave qe sigurojne ndricimin ,ajrosjen dhe hyrjan ne pjeset e mbrendshme te saj.Madhesite (dimensionet)e tyre jane te ndryshme.Pjeset kryesore te dyerve jane:Kasa e deres e fiksuar ne mur dhe e kapur nga ganxhat,vidat prej hekuri .(kasa e deres te jete derrase dhe 45cm)

Korniza e deres e cila lidhet me kasen me ane te vidave perkatese.

Riparimi I dritareve ka te beje me riparimin e dorezave dhe bllokuesve te dritareve. Vetratat duralumini perbehen nga material alumini te lyera perpara se te vendosen ne object. Korniza fikse e vetratave duhet te jete me elemente qe sherbejne per vendosje ne strukturat e murit.

4.PUNIME LYERJE

Procesi kalon ne tre faza :

-Pergatitja e siperfaqes qe do te lyhet .

Para lyerjes behet pastrimi I siperfaqes ,mbushja e gropave te vogla te siperfaqes se murit me ane te stukimit me material sintetik dhe berja gati per paralyerje .

-Paralyerja e siperfaqes se mbrendshme te pastruar.

Ne fillim te procesit behet paralyerja e siperfaqeve te pastruara me vinovil te holluar.Norma e perdorimit per 1 l perzierje vinovil me uje per 20 m2 siperfaqe.

-Lyerja e siperfaqes se mureve e tavanaeve do te behet me hidromat,fasada me hidromat plastik dhe banjot me gelqere.

5.PUNIME ELEKTRIKE

Punimet elektrike konsistojne ne shtrirjen e rrjetit te mbrendshem elektrik ne godine.Materialet e perdorura jane materialet qe parashikohen ne preventiv.

6. PUNIME HIDRAULIKE

Ne punimet hidraulike perfshihen dhe shtrimi i te gjithë rrjetit hidraulik ne te gjithë godine dhe paisjet sanitare perkatese sipas projektit dhe preventivit perkatese.

7.PUNIME TERRITORI

Sistemimit te oborrit te kopshtit duhet ti kushtohet nje rendesi e vecante .Kryesisht ambientet e jashtme te kopshtit ndahen ne ambiente perpara godine te cilat sherbejne per qendrim dhe shplodhje dhe ne ambiente sportive me lojra.Shtrimi I territorit te oborrit te kopshtit do te behet me pllaka betoni te cilat do te zgjidhen nga investitori dhe supervizori.Pllakat vendosen mbi nje shtrese rere.Shtresa e reres duhet te jete me kokrriza 2.5 mm deri 0.4 mm.Ajo do te rrafshohet dhe mbi te do te vendosen pllakat e betonit.Mbas vendosjes se pllakave ata me nje makine te posacme do te tunden ne ate menyre qe te arrihet nje rrafshesi perfekte.Me ne fund fugat e pllakave do te mbushen me rere te imet 0.1 mm ne ate menyre qe pllakat te lidhen mire me njera tjetren dhe te perforcohet e stabilizohet shtresa e pllakave te betonit.

Bordurat prej betoni jane te dimensioneve te ndryshme.Ato jane pjese te parapergatitura prej betoni dhe duhet te instalohen sipas menyres se pershkruar me poshte;Bordurat duhet te vendosen para se te behet shtrimi I siperfaqes Per te bere ate duhet hapur nje kanal ne dhe me dimensione sipas nevojës.Kanali duhet te jate te pakten 10 cm me I madh se bordurat.Ne ate futet beton I thate (I lagur pak) dhe bordurat vendosen mbi te.Nevoja e

betonit eshte 0.05m3 beton.Ne secilen an ate bordurave duhet te vendoset beton ne ate menyre qe ai te fiksohet dhe te mbaje fort borduren.

Kanalizimet

Rendesi ne sistemin e terrenit kane dhe kanalizimet e ujrave te bardha e te zeza.Per kanalizimet e ujrave te bardha do te perdoren tuba me dimensione 400mm ndersa per kanalizimin e ujrave te zeza te perdoren tuba me dimensione 300mm.Gjate vendosjes se tubave poshte te vendoset rere me qellim nivelimi.Shkarkimi te behet ne puseta me dimensione sipas percaktimit ne projekt dhe preventiv per ujrat e bardha . Eshte parashikuar dhe vendosja e stolave te drurit format dhe dimensionet te percaktohen nga investitori dhe supervizori.

RrethimiI objektit do te behet me kolona metalike dekorative dhe mbajttese.. Gjithashtu do behet dhe lyerja e tyre.Kangjellat te lyhen me boje vaji .

8.NGROHJA

Ngrohja e kopshtit eshte parashikuar me kaldaje dhe me kalorifere te montuar per secilin ambient.

